



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:077398
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05720489

C.nr.2448/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi nga Gjilani, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses SH.B nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.S, avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 1,040.06 euro, jashtë seancës, me datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses SH.B nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, që në emër të kualifikimit fakultet për periudhën kohore nga data 01.09.2021 – 31.01.2023, për 17 muaj, duke llogaritur nga 61.18 euro për çdo muaj, t'ia paguaj paditëses shumën prej 1,040.06 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 08.03.2024 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET paditësja që në afat prej 15 ditë, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, të paguaj taksën gjyqësore në bazë prej të diferencës së kontestit, në shumën prej 10.00 €, sipas nenit 12, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

III. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, më datë 08.03.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 1,040.06 euro.

Në padin e dt.08.03.2024, ka theksuar se e njëjta është e punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët (në vijim: SHMU) “Agimm Ramadani” në Gjilan, në pozitë e Mësimdhënëses së lëndës së Edukates Muzikore, pastaj ka vazhduar në SHFMU “Thimi Mitko” në Gjilan. Përkundër kualifikimit të saj me fakultet, asnjëherë nuk është kompensuar për atë që e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënëse, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën kohore nga data 01.09.2021 – 31.01.2023, e njëjta është kompensuar vetëm në shumën prej 52.49 euro për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç’rast e paditura i ka mbetur borxh në shumën prej 61.18 euro në muaj. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 21.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie punë tek e paditura (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar së paditëses me të paditurën, nr.prot.1165, e dt.01.09.2015, si dhe vërtetimi me nr.prot.04/158 i dt.05.02.2024, lëshuar nga SHFMU “Thimi Mitko” në Gjilan).

Nuk është kontestuese se e njëja ka diplomë të nivelit bachelor nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Arteve, (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.903 e dt.16.09.2014), është mësimdhënës e licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100022301 e dt.16.12.2014) dhe se pagën bazë e ka pasur në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 52.49 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me fakultet, pasi është paguar në shumën prej 52.49 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro, me ç'rast i ka mbetur borxh në shumën prej 61.18 euro, ndërsa periudha e kërkuar për këtë kompensim përfshin kohën sa ka qenë në fuqi Vendimi i Qeverisë dhe nuk është nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 08.03.2024, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga data 01.09.2021.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana

e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe detyroi paditësen që të paguaj diferencën e taksës gjyqësore në shumë prej 10 €, pasi paditësja me rastin e paraqitjes së padisë ka paguar vetëm shumën prej 21.00 €, për vlerën e kontestit 1,040.06 €, ndërsa bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, nenit 12, shuma për taksë gjyqësore për vlerën e kontestit prej 1,001.00 deri 2,500.00 është 30 €.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.2448/24, më datë 16.05.2024

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.